



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

| | | | |
|-----------------------------------------------|------------|--------------------|-------------------|
| Pranuar - Prilajmimi Më/Dana 01-02-2024 vitet | | | |
| Nr. i organit Org. broj | Numri/Broj | Shtetëse Prilog | Vlera Vrednues |
| 01 | 060+01 | | 114 |



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë në bazë të nenit 12, shkronja d, nenit 30 paragrafi 1 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), njoftimi i datës 12.12.2023 për ndërprerjen e marrëveshjes së bashkëpunimit, nenit 36, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 30.01.2024 miraton këtë:

V E N D I M

për anulimin e Vendimit me Nr.01-110/05-1225, të datës 31.10.2022 për miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Vitisë dhe Kolegjit UBT për hartimin e Hartave Zonale të Komunës së Vitisë

Neni 1

Me këtë Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për anulimin e Vendimit me Nr.01-110/05-1225, të datës 31.10.2022 për miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Vitisë dhe Kolegjit UBT për hartimin e Hartave Zonale të Komunës së Vitisë.

Neni 2

Anulimi i Vendimit me Nr.01-110/05-1225, të datës 31.10.2022 për miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Vitisë dhe Kolegjit UBT për hartimin e Hartave Zonale të Komunës së Vitisë bëhet nga mirëkuptimi i shprehur edhe në pjesën hyrëse të marrëveshjes së bashkëpunimit, në të cilën tekstualisht thuhet se: "DERISA, UBT dhe Komuna e Vitisë (më tutje referuar kolektivisht si "Palët" dhe individualisht si "Pala"), që njohin përfitimet e një bashkëpunimi të mirëfilltë, thelbësor dhe që dëshirojnë të ndjekin një bashkëpunim të tillë kanë hyrë në këtë Marrëveshje të Bashkëpunimit (më tutje referuar si "MB") në një frymë besimi dhe bashkëpunimi".

Neni 3

UBT-ja me datën 12.12.2023, në pajtim me dispozitat e neni VI të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Vitisë dhe kolegjit UBT për hartimin e Hartave Zonale të Komunës së Vitisë është njoftuar me shkresë zyrtare për ndërprerjen e marrëveshjes së cekur me lartë.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Vitisë.

Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8 lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për procedurat e hartimi dhe publikimi të akteve të komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

1. Zyrës së Kryetarit;
2. Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim...;
3. UBT-së;
4. MAPL-së; dhe
5. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
KRYESUESI
Bekim Azizi

